



Faqe 2

"Kosovarët jo që janë harruar, por janë shlyer si popull"



Faqe 3

Kushte deputetëve që duan komision për RTK-në



Faqe 3

KQZ-ja: Nuk do të ketë kamera në vendvotime



Faqe 7

Shënohet rasti i parë i gripit të derrave në Shqipëri

KOHA Ditore

Numri 4348 • e mërkurë, 22 korrik 2009 • Çmimi € 0.30


Letër e hapur

Faqe 11

Një rrugë përpara edhe për Kosovën!

E mirëpresim propozimin e fundit të Komisionit Evropian në lidhje me liberalizimin e vizave në Ballkanin Perëndimor. Ky është një hap i rëndësishëm përpara në një proces që do t'u mundësojë popujve nga Ballkani Perëndimor, sikur edhe evropianëve të tjerë, që të udhëtojnë të lirë nëpër Evropë. E çmijmë faktin që procesi i liberalizimit të vizave bazohet në kritere objektive. Qeveritë në rajon kanë detyrë që të zbatojnë reforma gjithëpërfshirëse për të përmirësuar sigurinë e BE-së dhe për të qetësuar brengat e qytetarëve të BE-së. Shtetet e Ballkanit Perëndimor janë kërkuar që të përmirësojnë kontrollin e kufijve të tyre, të futin në përdorim pasaporta biometrike që nuk mund të falsifikohen, dhe të vënë në vend strategji konkrete për luftimin e krimit të organizuar, korrupsionit dhe emigracionit ilegal. Tani, Komisioni Evropian ka gjetur se janë tri vende – Maqedonia, Serbia dhe Mali i Zi...

Me diell



Min. 18°C - Maks. 31°C

Aktivistë të shoqërisë civile të Kosovës apelojnë që BE-ja të ndërrojë politikën diskriminuese të vizave

Kosova rrezikon të shndërrohet në një "geto vizash"

"Fakti se Kosova do të izolohet nuk do të krijojë më shumë siguri për Bashkimin Evropian, por përkundrazi do të krijojë më shumë pasiguri për të gjithë ne, sepse ndjenja e izolimit krijon trend jozhvillimor dhe jodemokratik. Viza nuk do ta pengojë krimin, por përkundrazi do të krijojë kushte që përbrenda këtij izolimi të lulëzojë ajo që do të jetë krimi i vizave", ka thënë kryetari i Klubit për Politikë të Jashtme, Veton Surroi

KOHA Ditore

SAMI KASTRATI

PRISHTINE, 21 KORRIK – Përfaqësues të Shoqërisë Civile të Kosovës u kanë dërguar një apel liderëve kryesorë të Bashkimit Evropian dhe eurodeputetëve, duke i kërkuar që edhe Kosova të përfshihet në procesin e liberalizimit të vizave sa më shpejt që të jetë e mundur.

Në të kundërtën sipas tyre Kosova rrezikon të shndërrohet në një "geto vizash" pa kurrfarë rrugëdalje.

"Ky do të ishte rezultat i pashmangshëm i politikave të propozuara nga Komisioni Evropian, të cilat janë të pakuptimta dhe diskriminuese ndaj qytetarëve të Kosovës", ka thënë Luan Shllaku, nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur, duke e lexuar apelin e adresuar BE-së, të martën në një konferencë për media në Prishtinë.

"Të izolohen qytetarët e Kosovës dhe të bëhet presion shtesë në serbët e Kosovës, duke i veçuar të gjithë, si rrezik i posaçëm sigurie, është fyerje e pabazë. Propozimi i Komisionit Evropian, e nënvlerëson mundin tonë për të ndërtuar një Kosovë të hapur dhe multietnike. Bashkimi Evropian, që është shpresa jonë e vetme për një të ardhme demokratike, duhet të bëjë më shumë se kaq", është shprehur ai. Njëpërmjet këtij apeli shoqëria

civile ka kërkuar nga aktorët kryesorë të politikëbërjes në BE që këta të fundit të propozojnë sa më shpejt një udhërrëfyes që çon drejt liberalizimit të vizave për kosovarët. "Nëse 27 vendet anëtare të Bashkimit Evropian ishin në gjendje që të fusin Kosovën si një territor në listën e zezë, duke imponuar zyrtarisht vizat si pjesë e aneksit I të listës së zezë, ato gjithashtu mund të pajtohen që ta fusin Kosovën në listën e bardhë dhe gjithashtu mund të pajtohen për të ofruar udhërrëfyesin për Kosovën si hap i parë për të arritur liberalizimin e vizave", ka thënë Venera Knaus nga Iniciativa Evropiane e Stabilitetit, ESL. Kjo e fundit ka kërkuar gjithashtu që të ndahen çështja e njohjes së Kosovës dhe liberalizimit të vizave. "Në mënyrë që të adresohet ky problem, sa më herët dhe më shpejt që Kosovës i jepet ky shans, aq më mirë do të jetë për Kosovën dhe vendet e Bashkimit Evropian, të cilat janë të shqetësuara për Sigurinë", ka thënë ajo. Ndërkohë, kryetari i Bordit të Klubit për Politikë të Jashtme, Veton Surroi, ka paralajmëruar se problemi të ngjashme për Kosovën do të mund të ndodhin në gjithë rrugën e integritimeve evropiane.

(vijnë në faqen e dytë)



Policia gjen 25.000 fidanë kanabis në një fermë afër Lipjanit

Suhodoll, Lipjan, 21 korrik – Rreth 25.000 fidanë të bimës cannabis sativa, prej së cilës përfitohet droga e njohur si marihuanë, janë gjetur nga Policia e Kosovës në 3 hektarë tokë, pronë të një serbi, të marrë me qira nga një shqiptar, në fshatin Suhodoll të Komunës së Lipjanit. Policia nuk ka arrestuar asnjë person në lidhje me rastin, ndërkohë fermeri që ka marrë me qira tokën mohon se e ka mbjellë bimën narkotike

Arbëri

Faqe 7

Fshehja e kufomave në "varrezat ujore"

Forcat serbe të sigurisë kanë keqtrajtuar e vrarë civilë shqiptarë dhe më pas kanë tentuar që t'i fshihnin gjurmët e krimit, duke i hedhur apo varrosur kufomat në vende të ndryshme. Dëshmitë për këto janë prezantuar në raportet mjekoligjore të ekspertëve ndërkombëtarë, por edhe nga zyrtari i lartë i policisë serbe, të cilët, të martën, janë paraqitur para Gjykatës së Hagës në procesin kundër ish-ndihmësministrit...

Arbëri

Faqe 4

Keqpërdorimet i "bashkojnë" PDK-në dhe AAK-në

Shkeljet e ligjit, keqpërdorimet dhe mangësitë e shumta janë ato që i "bashkojnë" të dy Qeveritë e Kosovës, atë të drejtuar nga AAK-ja në mandatin e kaluar, dhe këtë të drejtuar nga PDK-ja në këtë mandat. Edhe pse koalicioni qeverisës të këtij mandati i është ndërruar partneri që drejton Qeverinë, thuaja asgjë nuk ka ndryshuar në krahasim me mandatin e kaluar...

Ekonomi

Faqe 12

Ligji "antidumping" merr dritën e gjelbër për Kuvend

Komisioni Parlamentar për Ekonomi, Tregti, Industri, Transport, i ka dhënë dritën e gjelbër amendamentimit të Ligjit për masat antidumping dhe masat kundërbalancuese, ndërsa miratimi i këtij ligji pritet të bëhet pasi deputetët e Kuvendit të Kosovës të kthehen nga pushimet. Ky ligj, në qoftë se gjen zbatim ashtu siç kanë vlerësuar të martën edhe anëtarët e këtij komisioni, mundëson caktimin e masave...

Botë

Faqe 14

700 viktima të gripit të derrave

Virusi i gripit të derrave H1N1 ka lënë të vdekur më shumë se 700 persona qëkur ka shpërthyer katër muaj më parë, ka njoftuar të martën Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH), e cila ka rekomanduar mbylljen e shkollave. Kjo është një shifër dy herë më e madhe krahasuar me prezantimin e fundit të numrit prej 429 viktimitash, të njoftuar më 6 korrik. Margaret Chan, drejtuese e përgjithshme e OBSH-së...

Parlamentarët evropianë interesohen për përfshirjen e Kosovës në liberalizim vizash

Kacin: Kosovaret jo vetëm se janë harruar, por janë shlyer si popull

Eurodeputeti sloven, Jelko Kacin, duke folur për mospërfshirjen e boshnjakëve dhe kosovarëve në liberalizim vizash, ka thënë se "kosovarët jo vetëm se janë harruar, por janë shlyer si popull". Ministri sudez, Bildt, ka thënë se rreth Kosovës duhet zgjidhur disa dallime brendainstitucionale në BE që mund të tejkalohen me vullnet të mirë

KOHA
DITORE

AUGUSTIN PALOKAJ

BRUKSEL, 21 KORRIK - Paraqitja e ministrit të Jashtëm të Suedisë, Carl Bildt, para deputetëve të Parlamentit Evropian ka qenë një rast për disa deputetë të këtij Parlamenti që të përsërisin kritikën e tyre për mospërfshirjen e boshnjakëve të Bosnjë-Hercegovinës në procesin e liberalizimit të vizave e disa e kanë përmendur edhe Kosovën. Carl Bildt ka folur për planet e Presidencës suedeze në fushën e politikës së jashtme deri në fund të këtij viti dhe ka përmendur Ballkanin Perëndimor ku duhet të përqendrohet po ashtu vëmendja e BE-së. Bildt ka thënë se duhet të vazhdohet procesi i zgjerimit të BE-së, sepse ky proces është i rëndësishëm për afro 100 milionë njerëz që presin para deryeve të BE-së (mendohet në Turqinë dhe vendet e Ballkanit Perëndimor). Bildt ka thënë se do t'i gëzojë një situatë në të cilën secili shtet i rajonit të Ballkanit do të bënte një shkallë më të lartë drejt integritetit në BE, përfshirë këtu edhe shqyrtimin e aplikacioneve që kanë dhënë Mali i Zi dhe Shqipëria, por edhe dorëzimin nga Serbia e Bosnjë-Hercegovina. Duke përmendur arrijtjet në Ballkan pas luftërave të përgjakshme, Carl Bildt ka thënë se „në Serbi kemi një qeveri më

demokratike deri tani, Mali i Zi dhe Shqipëria kanë bërë aplikimin formal për anëtarësim në BE, Kroacia po përparon në procesin negociator, ndërsa Kosova tashmë është shtet i pavarur". „Forcat integruese në Ballkan pas një kohe shumë të gjatë tash janë më të fuqishme sesa ato dezintegruese. Kemi një rast të mirë, por edhe në nga ana jonë duhet ta shfrytëzojmë momentin", ka thënë Bildt, duke përmendur disa bllokada në procesin e zgjerimit të BE-së, siç është edhe bllokimi që po ia bën Sllovenia Kroacisë. Disa deputetë të Parlamentit Evropian kanë shprehur zhgënjimin e tyre me propozimin e fundit të Komisionit Evropian për liberalizimin e vizave për disa vende të Ballkanit Perëndimor, sidomos për shkak të mospërfshirjes së boshnjakëve në këtë proces. Vërejtje për këtë kanë bërë deputetja nga Gjermania, Doris Pack, deputeti sloven, Jelko Kacin, ai nga Austria, Hanes Svoboda, por edhe disa deputet të tjerë. Ata e kanë quajtur këtë si „diskriminim dhe padrejtësi ndaj viktimave“ dhe kanë rikujtuar se, në rastin e Bosnjë-Hercegovinës, kroatët mund të udhëtojnë pa viza në BE me pasaporta të Kroacisë, ndërsa serbët e Bosnjës do të mund ta bëjnë këtë së shpejti me pasaporta të Serbisë e pa të drejtë

udhëtimi pa viza do të mbeten vetëm boshnjakët. „Kjo është një njoheje e ndarjeve etnike“, ka thënë Kacin, duke i bërë thirrje BE-së që sa më shpejt të mundësojë edhe liberalizimin e vizave për të gjithë qytetarët e Bosnjë-Hercegovinës, që të hyjë në fuqi gjithësesi para shënimit të 15-vjetorit të genocidit në Srebrenicë, pra para korrikut të vitit që vjen. Kacin ka përmendur edhe Kosovën, duke thënë se Kosova po trajtohet si shtet inekzistent dhe se „Kosovarët jo vetëm se janë harrur, por edhe janë shlyer si popull në këtë proces“. Duke i përgjigjur këtyre kritikave, Carl Bildt, që është kryesues i Këshillit të Ministrave të BE-së, ka thënë se këtu nuk ka kurrfarë befasishe dhe liderët në Ballkan e kanë ditur se çfarë do të ndodhë. „Në Bosnjë-Hercegovinë qytetarët janë viktimë të paafetësive të liderëve të tyre që të përbushin kriteret e nevojshme. Këtë u kemi thënë dhe u kemi bërë ftesë që të punojnë në këtë drejtim, sepse ankesat për diskriminim dhe kritikën ndaj bashkësisë ndërkombëtare nuk do të shpien askund“. Ndërsa për rastin e Kosovës, Bildt ka qenë paksa i paqartë dhe vetëm ka thënë se „rreth Kosovës duhet t'i zgjidhim disa dallime brendainstitucionale në BE që mund të tejkalohen me vullnet të mirë“.

Serbia demanton EULEX-in: S'ka negociata për kthimin e gjykatësve serbë

BEograd, 21 KORRIK (FO.NET) – Serbia nuk është duke negociuar kthimin e gjykatësve serbë nëpër gjykatat e Kosovës – Qeveria e Serbisë është duke kërkuar që së pari të përbushen kushtet e caktuara, ka deklaruar sekretari shtetëror i Ministrisë serbe të Drejtësisë, Slobodan Homen. „Në këtë moment nuk ka kurrfarë negociatash mes Beogradit dhe Prishtinës për kthimin e gjykatësve dhe prokurorëve në gjykatat në Kosovë“, ka thënë Homen në një deklaramin për gazetën „Politika“, duke demantuar deklaratën e zëdhënësës së EULEX-it, Kristiina Herodes. Sipas deklaratës së zëdhënësës së misionit të BE-së në Kosovë, janë duke u zhvilluar bisedimet mes Beogradit dhe Prishtinës në mënyrë që „të ecet përpara“ dhe që gjykatësit serbë të kthehen nëpër gjyqe në Kosovë, por edhe ata shqiptarë të kthehen në gjykatat në veri të Mitrovicës. Sipas zëdhënësës Herodes, ende nuk mund të flitet për datë të saktë të kthimit, sepse bisedimet po bëhen me ndërmjetësimin e EULEX-it dhe ato janë ende duke u zhvilluar. Por, zyrtari i Qeverisë serbe mohon një gjë të tillë. „Para fillimit të çfarëdo bisedimeve, Qeveria e Serbisë kërkon nga EULEX-i që t'i përgjigjet në disa pyetje esenciale. Para së gjithash, cilat rregullore do të aplikohen në gjykatat, ato që vlenë në Serbi, ato të UNMIK-ut, që janë aplikuar prej vitit 1999, ose eventualisht rregulloret e Qeverisë së Kosovës, që për ne

është tërësisht e papranueshme“, ka thënë Homen. Sipas tij, me rëndësi është nëse gjykata në Mitrovicë do t'i gjykojë edhe qytetarët nga pjesa jugore e qytetit, apo do të jetë përgjegjëse vetëm për rastet nga pjesa veriore e Mitrovicës. „Kjo çështje është e rëndësishme, sepse prej saj varet edhe struktura nacionale e gjykatësve. Paraku shteti i tretë që Beogradi kërkon të përbushet është që të përcaktohet se ku do të gjendet gjykata e shkallës së dytë. Sipas Ligjit për organizimin territorial të Serbisë, instanca më e lartë do të ishte Gjykata në Nish“, tha Homen. „Këto pyetje praktike janë shumë esenciale nga pikëvështrimi i jurisprudencës. Në jemi të gatshëm dhe të hapur për negociata për kthimin e gjykatësve dhe prokurorëve serbë, por ata nuk mund të kthehen 'qorrazë', e më pas të zgjidhen disa gjëra konkrete që mund të jenë konstatuese“, ka thënë Homen, duke shtuar se shpreson që prej EULEX-it së shpejti do të arrijë përgjigjja në pyetjet, të cilat Beogradi i ka shënuar si të hapura. Më tutje, ky zyrtar i Ministrisë serbe të Drejtësisë ka paralajmëruar se prej 1 janarit të vitit të ardhshëm, Ministria serbe e Drejtësisë në Mitrovicë do të themelojë gjykatën themelore, gjykatën e lartë dhe gjykatën për kundërvajtje. Sipas tij, këto do të jenë gjykatat amë për organet e drejtësisë serbe në territorin e Kosovës.

Aktivistë të shoqërisë civile të Kosovës apelojnë që BE-ja të ndërrojë politikën diskriminuese të vizave

Kosova rrezikon të shndërrohet në një "geto vizash"

"Fakti se Kosova do të izolohet nuk do të krijojë më shumë siguri për Bashkimin Evropian, por përkundrazi do të krijojë më shumë pasiguri për të gjithë ne, sepse ndjenja e izolimit krijon trend jozhvillimor dhe jodemokratik. Viza nuk do ta pengojë krimin, por përkundrazi do të krijojë kushte që përbrenda këtij izolimi të lulëzojë ajo që do të jetë krimi i vizave", ka thënë kryetari i Klubit për Politikë të Jashtme, Veton Surroi

(vijon nga ballina)

"Kjo ka të bëjë jo vetëm me vizat, por me integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian, ku Kosova e izoluar në çështjen e vizave do të jetë e izoluar edhe në aspekte të tjera integruese. Dhe ky është një lajm dyfish i keq për Kosovën, por do të duhej të ishte edhe dyfish i keq edhe për rajonin", ka thënë Surroi.

Sipas tij, mospërfshirja e Kosovës në procesin e liberalizimit të vizave vetëm sa do ta rrisë pasigurinë dhe stimulimin e krim-it.

"Fakti se Kosova do të izolohet nuk do të krijojë më shumë siguri për Bashkimin Evropian, por përkundrazi do të krijojë më shumë pasiguri për të gjithë ne, sepse ndjenja e izolimit krijon trend jozhvillimor dhe jodemokratik. Viza nuk do ta pengojë krimin, por përkundrazi do të krijojë kushte që përbrenda këtij izolimi të lulëzojë ajo që do të jetë krimi i vizave", është shprehur Surroi.

Veç kësaj ai ka thënë se ekziston një "shpërputhje në mes bashkësisë ndërkombëtare dhe Kosovës".

"Si është e mundur që Kosova të ketë një partneritet me bashkësinë ndërkombëtare

për sa i përket EULEX-it dhe ta dorëzojë sundimin e ligjit EULEX-it, ndërkohë që po ai EULEX nuk mund të prodhojë një gjendje të një afërsie apo një komunikimi më intensiv rreth vizave", ka pyetur ai.

Kritikat e Surroit kanë shkruar edhe në adresë të Qeverisë së Kosovës rreth asaj se nuk i kanë kushtuar as kujdesin minimal në trajtimin e çështjeve teknike.

Komisioni Evropian pak ditë më parë ka propozuar heqjen e vizave për shtetet fqinje, Serbinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi, por jo edhe për Shqipërinë dhe Bosnjë-Hercegovinën, pasi që sipas tyre këto dy shtete të fundit nuk i kanë përbushur kushtet teknike.

Kosova deri tash nuk ka qenë fare e përfshirë në procesin e liberalizimit të vizave. Qeveria e Kosovës kohë më parë e ka miratuar një udhërrëfyes në mënyrë unilaterale në plotësimin e kushteve që dalin nga ky proces.

Në vizitën e tij që i ka bërë pak ditë më herët Kosovës, Përfaqësuesi i lartë i BE për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Javier Solana, ka thënë se kur është iniciuar ky proces Kosova nuk ka qenë shtet, megjithëse ai ka premtuar se liberalizimi i vizave do të vazhdojë edhe me shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor.



Shoqëria Civile e Kosovës i ka bërë apel Bashkimit Evropian që mos ta getozojë Kosovën me politikën diskriminuese të vizave